



Si e Ndjek Ema Jezusin

Ema e ndjek Jezu Krishtin duke qenë e sjellshme. Ajo dëshiron të jetë shoqe me të gjithë! I pëlqen të flasë me njerëz dhe të luajë lojëra me fëmijët e tjerë. “Më pëlqen të luaj me miqtë e mi dhe t’u jap dhurata ngaqë më pëlqejnë njerëzit” – thotë Ema. Ndonjëherë ajo bën kartolina për miqtë dhe familjen e saj.

Ema e ndihmon gjithashtu mamin e vet të kujdeset për vëllezërit e saj binjakë. Ajo ndihmon për përgatitjen e vakteve ushqimore për familjen e saj dhe i ushqen me biberon vëllezërit e saj foshnja. “Ndihem mirë dhe e lumtur kur ndihmoj. E di se Ati Qiellor do të më bekojë” – thotë Ema. ●



Edhe Ti Mund ta Ndjekësh Jezusin!

Çfarë është diçka që e ke bërë për ta ndjekur Jezusin? Na shkruaj dhe na trego! Kthehu te kapaku i pasmë për të parë mënyrën.



Halo!



Rreth Emës

Mosha: 10 vjeçe

Nga: Shefa, Vanuatu

Gjuhët: anglisht, bislamisht, fixhianisht

Synimet: 1) Të shkojë në mision. 2) Të jetë pilote.

Veprimtaritë e parapëlqyera: Noti dhe karaoke

Familja: Ema, mami, babi, një motër dhe dy vëllezër

Gjërat e Parapëlqyera të Emës

Historia nga Libri i Mormonit: Lehi dhe familja e tij largohen nga Jerusalemi (shih te 1 Nefi 2)

Tradita për festa: T’u japë miqve karamelle dhe kartolina për Pashkë

Fruta dhe perime: Banane, mollë, portokalle, shalqi, sallatë jeshile dhe karota

Ngjyra: Rozë

Kënga e Fillores: “Familjet Mund të Jen’ Bashk’ Përgjithmon!” (Libri i Këngëve të Fëmijëve, f. 98)

Ndjekja e Jezusit në Vanuatu